

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për të Mitur me trupin gjykues për të mitur të përbërë nga gjyqtarja për të mitur Besarta Doli kryetare, gjyqtarëve porotë Fahredin Meqa dhe Shpresa Mangjuka anëtar, si dhe me sekretaren juridike Shkendije Halilosmani, në lëndën penale kundër të akuzuarve **S.SH** nga R. dhe **A.T** nga Gj. për shkak se si bashkë kryes kanë kryer veprën penale të keqtrajtimit apo braktisja e fëmijës nga neni 211 parag. 2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Publike Komunale në Prizren PP.nr. 3013/2009 të datës 22.12.2009, pas shqyrtimit gjyqësor verbalo – jo publik, të mbajtur më **datë 22.02.2017**, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, prokurorit për të mitur Xhavit Osmani, të akuzuarve **S.SH** nga R. dhe **A.T** nga Gj., si dhe mbrojtësit të viktimave A.P. të njëjtën ditë, mori dhe shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari S.Sh. nga R. me banim në rrugën “ V.F” nr... biri i G.dhe i H. e gjinisë K., i lindur me datë ... në R. ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë – invalid, i martuar atë i 7 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i pa dënuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal...

E akuzuara A.T. nga Gj. me banim në rrugën “ K.K” nr... e bija e M. dhe K. e gjinisë K. e lindur me datë... në Gj. ka të kryer shkollën fillore, amvise, e shkurorëzuar, nënë e 7 fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

J a n ë f a j t o r

Sepse me datë 17.II.2009 në R. e braktisin fëmijën e tyre të porsalindur mbi të cilin ushtrojnë autoritet prindëror, duke e rrezikuar dhe dëmtuar rëndë shëndetin e tij, në atë mënyrë që pasi e pandehura e dytë (A), përndryshe bashkëshortja e të pandehurit të parë e lind fëmijën e shtatë me radhë të gjinisë femërore, në martesë faktike dhe juridike me të pandehurin e parë, në Repartin gjinekologjik të Shtëpisë së Shëndetit në Rahovec, për shkak të raporteve jo të mira të tyre mes vete, refuzojnë ta marrin nga spitali fëmijën e tyre dhe të njëjtin e braktisin duke e lënë në spital edhe për kundër kërkesës të personelit mjekësor të repartit, që fëmijën e tyre ta marrin, refuzojnë marrjen e tij, e më pas organi komunal i kujdestarisë në R. fëmijën e braktisur e merr dhe e vënë në mbikëqyrje dhe strehim të sigurt.

-Me çka ka kryer veprën penale, të keqtrajtimit apo braktisja e fëmijës nga neni 211 parag. 2 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Andaj Trupi gjykues për të Mitur, në kuptim të dispozitës së nenit 2,3, 6, 7, 31, 41, 42 prag. 1, pika 1.2, 49 parag. 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 211 parag. 2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës, nenit 145 parag. 1 pika 1.16 Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, ia i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

1. Të akuzuarit **S.Sh.** i shqiptohet dënim burgu në kohëzgjatje prej **katër (4) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk do të kryen vepër tjetër penale.

2. Të akuzuarës **A.T.** i shqiptohet dënim burgu në kohëzgjatje prej **katër (4) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk do të kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ta paguaj shumën sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej **20.- €**, e krejt këto në afat prej **15 ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Arsyetim

Ish Prokuroria Publike Komunale në Prizren, ka ngritur aktakuzë PP.nr. 3013/2009 të datës 22.12.2009 në ish Gjykatën Komunale në Rahovec me datë. 30.12.2009, kundër të akuzuarve **S.SH** nga R. dhe **A.T** nga Gj. për shkak se si bashkë kryes kanë kryer veprën penale të keqtrajtimit apo braktisja e fëmijës nga neni 211 parag. 2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, në kohë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës.

Duke u bazuar në Ligjin mbi Gjykatat të Republikës së Kosovës nr. 03/L-199, dhe dispozitat e kodit të ri të procedurës penale, të cilët kanë hyrë në fuqi nga 01. Janari i vitit 2013, si dhe dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, për të vendosur lidhur me këtë çështje juridiko-penale, kompetente do të jetë Departamenti për të Mitur, pranë kësaj gjykate.

Kjo lëndë penale nga Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, me datë 25.01.2017, është dërguar në kompetencë pranë gjykatës sonë Departamenti për të Mitur bazuar në nenin 145 parag. 1 nën parag. 1.16 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur .

Me datë 22.02.2017, është caktuar mbajtja e shqyrtimi gjyqësor, në të cilën janë të ftuara të gjitha palët .

Në shqyrtimin gjyqësor të akuzuarit e kanë pranuar në tërësi fajësinë, me ç'rast Gjykata ka vërtetuar se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 parag. 1, pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të po këtij Kodi, përkatësisht vlerësoj se të njëjtit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban akuza. Po ashtu ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë nga rrethanat për hedhjen e akuzës apo të pushimit të procedurës penale e paraparë me nenin 248 parag.3 të KPP-së.

Meqenëse të akuzuarit në shqyrtimit gjyqësor kanë pranuar fajësinë, Gjykata nuk është lëshuar në nxjerrjen e provave të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike dhe ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, prokurori për të mitur Xhavit Osmani në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e çmoj gatishmërinë e tyre dhe pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga ana e të dy të akuzuarve, me çka me këtë është vërtetuar edhe gjendja faktike e përshkruar sipas Aktakuzës PP.nr. 3013/2009 të datës 22.12.2009, konsideroj se në veprimet e të akuzuarve në rastin konkret formohen të gjitha elementet e veprës penale e cila iu vihet në barrë. Andaj, kërkoj nga gjykata që të njëjtit ti shpall fajtor, ti dënoj sipas ligjit, dhe ti obligoj në pagesën e shpenzimeve gjyqësore, si dhe gjatë matjes së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese siç janë pranimi i fajësisë, gjendja e tyre ekonomike, gjendja e krijuar pas kryerjes së veprës penale, pasi që të njëjtit tani janë të shkurorëzuar, fëmijë i braktisur është i adaptuar me pëlqimin e tyre dhe kanë kaluar nga kryer e veprës penale shtatë vite.

Mbrojtësi i viktimave A.P. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit.

I akuzuari S.Sh. gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë vullnetare ka pranuar fajin për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe për të njëjtën është penduar, shton se fëmijën nuk ka mundur ta marr në shtëpi, për shkak se nuk i ka pasur kushtet, ka pasur edhe 6 fëmijë të tjerë tek shtëpia dhe se raportet me ish bashkëshorten e tij këtu të akuzuarën A. i ka pas të acaruar dhe në atë kohë menjëherë është shkurorëzuar dhe në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se pendohet për veprën e kryer dhe i premtoj gjykatës që nuk do të përsërisë këto veprime .

E akuzuara A.T. gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë vullnetare, e ka pranuar fajin për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ka shkuar se se është e vërtetë që fëmijën e kam braktisur, pasi e kam dëgjuar ish bashkëshortin tim i cili më ka thënë “ ose mua ose fëmijën”, dhe unë kam gabuar dhe kam braktisur fëmijë dhe këtë e kam bërë me pëlqimin e të dyve dhe sa kam informacione unë e di që ky fëmijë është i adaptuar siç na kanë thënë nga QPS në R. dhe në fjalën e saj përfundimtare deklaroi se pendohem për veprën e kryer dhe i premtoj gjykatës që këto veprime nuk do të përsëriten në të ardhmen.

Në shqyrtimin gjyqësor trupi gjykues për të mitur ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u mbështetur nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të dy të akuzuarve e i cili pranim ka mbështetje në faktet dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë : deklarata e të akuzuarve dhënë në procedurën paraprake, në polici si dhe në prokurori, raporti i shkurtë policor me numër të rastit 2009 GC 479 të dt. 17.11.2009, të lëshuar nga Stacioni Policor në Rahovec, raporti i oficeres D.K dhe E.R. e dt. 18.11.2009, propozimi për zgjidhjen e martesës e datës 21.10.2009, si dhe shkresat tjera përbërëse në lëndë

Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha elementet – tiparet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të njëjtit ti shpall fajtor dhe ti gjykoj në bazë të Ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Gjykata me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, si rrethana lehtësuese për të akuzuarit gjeti pranimin e fajësisë, pendimin e tyre, dhe zotimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla penale, kohën e kaluar nga koha e kryerjes së veprës penale ku kanë kaluar mbi 7 vite, paraqiten për herë të parë para gjykatës dhe ndaj tyre nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, fëmija i

braktisur është adaptuar me pëlqimin e dy të akuzuarve. Ndërsa sa i përket rrethanave rënduese trupi gjykues për të mitur nuk gjeni.

Gjykata sipas bindjes së saj, vlerësoj se shqiptimi i dënimit me kusht , i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk do të kryejnë të akuzuarit veprën tjetër penale, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të tyre dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i tij i paraparë në nenin 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 të KPP-së.

Pas shpalljes së këtij Aktgjykimi, palët udhëzohen për të drejtën në ankesë dhe detyrimin e tyre për njoftimin e gjykatës për çdo ndërrim të vendbanimit deri në përfundim të kësaj çështje penale dhe pasojat që mund të rrjedhin nga kjo në përputhje me nenin 368 parag. 1 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
DEPARATAMENTI PËR TË MITUR
P.nr. 64/2017 të datë 22.02.2017

Sekretarja juridike,
Shkendije Halilosmani

Kryetarja e trupit gjykues për të mitur-Gjyqtarja
Besarta Doli

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, Departamentin për të Mitur, në afat prej **15 ditëve** nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet përmes kësaj Gjykate.